

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 65/2014 “PËR AGJENCINË E INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË MBROJTJES”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ligji 65/2014 “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes” është i miratuar në vitin 2014 dhe, krahas ndryshimit të emërimit të institucionit (nga Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes në Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes-AISM), solli disa ndryshime në misionin, detyrat, kriteret e emërimit të drejtuesve të lartë të AISM.

Gjatë këtyre viteve funksionimi i këtij ligji ka hasur në problematika në lidhje me zbatimin e të gjitha atributëve që duhet t'i siguronte ky akt ligjor AISM në realizimin e misionit të saj. Ndryshimi i këtij ligji vjen si pasojë edhe e ndryshimeve në sistemin e drejtësisë dhe në institucionet e tjera, siç janë: Prokuroria, gjykatat, krijimi i SPAK-ut, dhe nxjerrja e ligjit për Policinë e Shtetit, institucione me të cilat AISM bashkëpunon për realizimin e misionit të saj.

Qëllimi i këtyre ndryshimeve ligjore është që të mundësojnë që e gjithë struktura të realizojë misionin në mbështetje të ligjit dhe të rregullojë marrëdhëniet me strukturat e tjera ligj zbatuese.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj ka karakter teknik dhe nuk lidhet me programin politik të Këshillit të Ministrave. Projektligji është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, për Ministrinë e Mbrojtjes, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. ---, datë --.--.2022.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Në procesin e reformimit të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes në vitin 2014, ligji 65/2014 “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes” ishte pjesë përbërëse në reformën e plotë të kuadrit ligjor të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, me qëllim përmirësimin e veprimtarisë së kësaj agjencie dhe qartësimin e veprimtarisë informative bazuar në legjislacion të qartë dhe të harmonizuar me legjislacionin kombëtar. Por faktorë të tjerë të rëndësishëm kanë bërë të domosdoshëm rishikimin e plotë të legjislacionit ekzistues të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe përmirësimin e kuadrit ligjor, në përputhje me vetë specifikën e veprimtarisë së kësaj agjencie, si p.sh.:

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 65/2014 “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”.

- a) Ndryshimi i ambientit të sigurisë dhe natyra e kërcënimeve e rreziqeve, me të cilat përballen Forcat e Armatosura në kryerjen e misionit të tyre të cilat në ditët e sotme shfaqen në forma asimetrike të tilla si: terrorizmi, ekstremizmi, krimi i organizuar, armët e shkatërrimit në masë, kërcënime kibernetike dhe ajo e ditëve të fundit pjesëmarrja vullnetare e të rinjve të shteteve të ndryshme.
- b) Mësimet e nxjerra gjatë aplikimit të ligjit ekzistues nr.65/2014 “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes” dhe boshllëqet e vërejtura, të cilat sjellin pengesa në zbatueshmërinë e ligjit dhe vështirësojnë funksionimin normal dhe ligjor të veprimtarisë të kësaj agjencie.

Gjithashtu, disa shtesa e ndryshime janë gjykuar objektivisht të nevojshme për të mbështetur dhe trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë punonjësit si ata ushtarakë dhe ata civilë që janë pjesë e strukturës së AISM.

Ky projektligj do të mundësojë rregullimin e marrëdhënieve ligjore që aktualisht janë të pambshtetura në ligjin në fuqi dhe që nuk mund të funksionojnë midis strukturës së AISM dhe agjencive të tjera ligjzbatuese. Po kështu, projektligji do të ofrojë një pozitë ligjore të munguar në realizimin e misionit dhe detyrave të AISM nga vetë kapacitetet e saj, pa pasur nevojën e strukturave të tjera, duke krijuar kështu një autonomi veprimi ligjor të mbështetur në ligj.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në përputhje të plotë me rendin juridik të brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Projektligji nuk synon përafrim me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ligji 65/2014 “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes” është i miratuar në vitin 2014 dhe, krahas ndryshimit të emërimit të institucionit (nga Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes në Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes-AISM), solli disa ndryshime në misionin, detyrat, kriteret e emërimit të drejtuesve të lartë të AISM.

Ky projektligj përbëhet nga 30 nene.

Më konkretisht:

Në nenin 1 parashikohet që në nenin 4 të ligjit 65/2014 të hiqen pikat 8, 9, 10, 11, 13, 14, 15, ku do të përfihet shpjegimi vetëm i disa përkufizimeve kryesore, pasi të tjerat gjejnë vend në rregulloret përkatëse të veprimtarisë operativo-informative.

Në nenin 2 parashikohet që neni 7 ndryshon dhe bëhet

Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes kryen këto detyra:

- a) përpunon kërkesat strategjike vjetore për inteligjencë;
- b) paraqet, produkt inteligjence të nivelit strategjik dhe operacional për autoritetet e drejtim - komandimit të Forcave të Armatosura, në përputhje me parimin “nevojë për njohje”; informon Presidentin dhe Kryeministrin nëpërmjet Ministrit të Mbrojtjes;
- c) grumbullon dhe shpërndan të dhëna e informacione, si dhe paraqet produkt inteligjence në funksion të sigurisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura nga kërcënimet që mund t’i vijnë asaj nga aktorë shtetërorë dhe jo shtetërorë që ndodhen dhe kryejnë veprimtarinë e vet në zonën përgjegjësisë dhe interesit të AISM;
- ç) përgatit dhe paraqet produkt inteligjence, lidhur me kërcënime të natyrës së terrorizmit, ekstremizmit, spiunazhit, sabotazhit, diversionit, subversionit, armëve të shkatërrimit në masë, kërcënimeve kibernetike e krimit të organizuar ndaj kapaciteteve mbrojtëse të vendit;
- d) kryen veprimtari mbështetëse tekniko- administrative, sipas nevojave të saj;
- dh) merr pjesë në procedurat për pajisjen me “certifikatë sigurie” të personelit ushtarak dhe civil të Ministrisë së Mbrojtjes, të Forcave të Armatosura dhe “certifikatë sigurie industriale” të subjekteve që kërkojnë të hyjnë në marrëdhënie me to;
- e) shkëmben produkt inteligjence, bashkëpunon dhe kryen operacione të përbashkëta me struktura të inteligjencës së NATO-s dhe BE-së, me shërbime dhe me agjenci të inteligjencës së vendeve anëtare të NATO-s e të BE-së dhe agjencitë partnere në interes të mbrojtjes kolektive;
- ë) kontribuon me personel, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi në NATO, BE, OKB dhe në çdo organizëm tjetër ndërkombëtar ku shteti shqiptar është ose synon të bëhet palë;
- f) garanton sigurinë e veprimtarisë së vet, të personelit, të informacionit, infrastrukturës dhe të sistemeve të komunikimit, shkëmbimit, transmetimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” ose të NATO-s;
- g) organizon dhe kryen arsimim dhe trajnim profesional për punonjësit e strukturave të inteligjencës ushtarake, në kuadër të sistemit arsimor të Ministrisë së Mbrojtjes, të NATO-s dhe në kuadër të bashkëpunimit me shërbimet homologe dhe partnere;
- gj) kryen detyra të tjera brenda misionit të saj, të përcaktuara në rregulloren e funksionimit të kësaj Agjencie;
- h) në zbatim të shkronjave “c”, “ç”, “dh” dhe “e”, Ministri i Mbrojtjes miraton rregullore me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të kësaj Agjencie.

Në nenin 3 parashikohet që në nenin 8, pika 3, shkronja f, hiqet “... dhe të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”, pasi AISM është institucion në varësi të drejtpërdrejtë të ministrit të Mbrojtjes.

Në nenin 4 parashikohet që neni 10 të shkrihet në nenin 9 i cili ndryshon dhe bëhet

1. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është autoriteti më i lartë drejtues dhe përgjegjës për veprimtarinë e institucionit.
2. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes këshillon ministrin e Mbrojtjes dhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura për çështje të zbulimit, kundërzbulimit dhe sigurisë së mbrojtjes.
3. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është ushtarak aktiv.
4. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra nga ministri i Mbrojtjes (të Kryeministrit me propozim të Ministrit të Mbrojtjes).
5. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është autoriteti që përfaqëson strukturat e inteligjencës ushtarake shqiptare në marrëdhëniet me institucionet brenda vendit, NATO-n, BE-në dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë.
6. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ka këto detyra dhe përgjegjësi:
 - a) drejton, organizon dhe menaxhon veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi.
 - b) siguron zbatimin e ligjshmërisë për veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi.
 - c) raporton te ministri i Mbrojtjes për veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.
 - ç) i propozon ministrit të Mbrojtjes tabelën e organizimit dhe pajisjeve të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.
 - d) emëron, liron ose shkarkon nga detyra, komandon punonjës in ushtarak nën oficer dhe ushtar dhe punonjës in civil, ekuivalent me punonjës in ushtarak, nën oficer dhe ushtar, sipas tabelës së organizimit dhe pajisjeve të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.
 - e) nënshkruan marrëveshjet e bashkëpunimit dy ose shumëpalëshe me strukturat e inteligjencës brenda dhe jashtë vendit, me miratimin e ministrit të Mbrojtjes.
 - ë) nxjerr urdhra dhe udhëzime të karakterit ushtarako-administrativ brenda kompetencave të tij.
 - f) kryen detyra të tjera, të përcaktuara në akte të tjera ligjore e nënligjore.

Në nenin 5 bëhet shfuqizimi i neni 10 pasi është përfshirë në nenin 4.

Në nenin 6 parashikohet që në nenin 11, pika a, ndryshon dhe bëhet “të ketë eksperiencë pune në pozicione drejtuese në struktura të inteligjencës ushtarake, ose Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Komandat e Forcave, përfaqësitë apo shtabet e NATO-s”.

Disa nga kriteret për emërimin e drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes bëhen më të përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse. Përveç kriterëve të përcaktuara në nenin 31 të këtij ligji dhe të tjera në këtë nen, të ketë eksperiencë pune në pozicione drejtuese në struktura të inteligjencës ushtarake, ose Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, ose Komandat e Forcave, ose përfaqësitë apo shtabet e NATO-s.

Në nenin 7 parashikohet që titulli i nenit 12 ndryshon dhe bëhet “Zëvendës drejtori i Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”.

1. Zëvendës drejtori i Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është civil.
2. Zëvendës drejtori i Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra nga ministri i Mbrojtjes me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.
3. Në rast të mungesës së drejtorit të Përgjithshëm, ai zëvendësohet nga zëvendës drejtori i Përgjithshëm.

Ndryshimet të bëhen, sepse propozohet që agjencia të ketë vetëm një zëvendës drejtor të Përgjithshëm dhe ai të jetë civil.

Në nenin 8 parashikohet që në nenin 13, pika a, ndryshon dhe bëhet “të ketë shërbyer për një periudhë jo më pak se 15 vjet në struktura të inteligjencës ushtarake ose civile apo në institucione me natyrë të ngjashme me to”.

Disa nga kriteret për emërimin e zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes bëhen më të përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse. Përveç kriterëve të përcaktuara në nenin 31 dhe 34 të ligjit 65/2014 dhe të tjera në këtë nen, të ketë shërbyer për një periudhë jo më pak se 15 vjet në struktura të inteligjencës ushtarake ose civile apo në institucione me natyrë të ngjashme me to.

Në nenin 9 parashikohet që në nenin 16, pika 1, ndryshon dhe bëhet “Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes krijon qendra inteligjence që funksionojnë jashtë vendit në mënyrë të përkohshme, në zona përgjegjësie dhe zona interesi në mbështetje të Forcave të Armatosura”, për përputhshmëri me nenin 3 të këtij projektligji.

Në nenin 10 parashikohet që neni 18 të shkrihet në nenin 17 i cili ndryshon dhe bëhet “Burimet dhe grumbullimi i informacionit”

1. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në përmbushje të misionit të saj, përdor dhe shfrytëzon për grumbullim informacioni të gjithë disiplinat e inteligjencës.

2. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në përmbushje të misionit të saj, përdor dhe shfrytëzon për grumbullim informacioni sisteme apo baza të dhënash në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
3. Të dhënat e përftuara nga sistemet apo bazat e të dhënave, të mbledhura për qëllimet e këtij ligji, administrohen dhe përdoren vetëm për këtë qëllim, në përputhje me dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.
4. Burimet sinjalore të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes grumbullojnë informacion vetëm me natyrë zbulimi jashtë vendit.
5. Procedurat specifike për grumbullimin e informacionit miratohen me rregullore të përbashkët të ministrit të Mbrojtjes dhe titullarëve të institucioneve përkatëse sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Në këtë nen janë shkrirë në një burimet dhe grumbullimi i informacionit. Kjo pasi në ligjin aktual janë shumë të detajuara, duke nxjerrë në pah kësioj mënyrat dhe metodat e punës operativo-informative. Gjithashtu, në funksion të përfuturit të të dhënave sa më të sakta dhe në kohë reale, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në përmbushje të misionit të saj, përdor dhe shfrytëzon për grumbullim informacioni sisteme apo baza të dhënash në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në nenin 11 bëhet shfuqizimi i nenit 18 pasi është përfshirë në nenin 10.

Në nenin 12 parashikohet që neni 22 të shkrihet në nenin 21 i cili ndryshon dhe bëhet “Ndalimi i veprimtarisë jashtë misionit”.

1. Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes i ndalohet të kryejë veprimtari të karakterit policor.
2. Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes i ndalohet të kryejë veprime për të realizuar qëllime e objektiva që nuk kanë lidhje me misionin e saj.

Në nenin 13 bëhet shfuqizimi i nenit 22 pasi është përfshirë në nenin 12.

Në nenin 14 parashikohet që në nenin 28, pika 5, ndryshon dhe bëhet “Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes i nënshtrohet procesit të arsimimit, trajnimit dhe kualifikimit në institucionet arsimore ushtarake dhe civile brenda dhe jashtë vendit”.

Në këtë mënyrë hiqet detyrimi ligjor që punonjësi i AISM duhet të kryejë kursin bazë në Institutin e Shërbimit Informativ të Shtetit dhe jep më shumë hapësirë për avancim profesional duke njohur të drejtën e punonjësve që t’i nënshtrohen procesit të arsimimit, trajnimit dhe kualifikimit në institucionet arsimore ushtarake dhe civile brenda dhe jashtë vendit.

Në nenin 15 parashikohet që në nenin 29 pika 2 dhe 3, ndryshojnë dhe bëhen

2. Funksion të nivelit të lartë drejtues janë:
 - a) Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

b) Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm.

3. Funksion i nivelit të mesëm drejtues është drejtor drejtorie.

Pozicioni i zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes përcaktohet si funksion të nivelit të lartë drejtues. Kjo bazuar në VKM nr.187, datë 08.03.2017 “Miratim i strukturës dhe nivelit të pagave të nëpunësve civilë” por edhe eksperiencën e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

Në nenin 16 parashikohet që:

1. Në nenin 30, pika 1, shkronja h, hiqet togfjalëshi “që kanë objekt të veprimtarisë së tyre çështje të sigurisë ose të mbrojtjes”, pasi një kriter i tillë kufizon rekrutimin e individëve me formim arsimor përtej fushës së sigurisë.
2. Në nenin 30, pika 4 togfjalëshi “Kriteret për plotësimin e kushtit të sigurisë” ndryshon dhe bëhet “Kriteret dhe procedurat për plotësimin e kushtit të sigurisë”, sepse qartëson kuadrin nënligjor të nevojshëm për miratim dhe zbatim.

Në nenin 17 parashikohet që në nenin 31, pika 3, ndryshon dhe bëhet “Shpallja e vendit të lirë të punës bëhet nga Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, të paktën, 30 ditë para datës së caktuar për konkurrim”, duke ndryshuar vend shpalljen e vendit të lirë të punës për t’u përshtatur me procedurat aktuale të Ministrisë së Mbrojtjes.

Në nenin 18 parashikohet që në nenin 32, në pikën 2, shtohet shkronja c, “çdo formë tjetër të përshtatshme të verifikimit të aftësive”.

Ky ndryshim bëhet me qëllim mundësimin e përzgjedhjes së kandidatëve më të mirë.

Në nenin 19 parashikohet që

Në nenin 33, në pikën 1 dhe 2 togfjalëshi “Punonjësi, ushtarak dhe civil,” ndryshon dhe bëhet “Kandidati”.

Në nenin 33, në pikën 1, fjalia e fundit ndryshon dhe bëhet “Gjatë kësaj periudhe punonjësi duhet të kryejë trajnim familjarizues me objekt njohjen me procedurat e punës në AISM”.

Në pikën 1 saktësohet se gjatë kësaj periudhe punonjësi duhet të kryejë trajnim familjarizues me objekt njohjen me procedurat e punës në AISM. Është hequr “kursin bazë në qendrën e trajnimit”, pasi një qendër e tillë nuk ekziston në strukturën aktuale të AISM duke konfirmuar kërkesën e një trajnimi familjarizues për çdo punonjës të ri në AISM.

Në nenin 20 parashikohet që 34 ndryshon dhe bëhet

1. Emërimi, lirimi ose shkarkimi nga detyra i punonjësit ushtarak oficer ose i punonjësit civil ekuivalent me të, sipas tabelës së organizimit dhe pajisjeve, bëhet nga ministri i Mbrojtjes, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

2. Emërimi, lirimi ose shkarkimi nga detyra i punonjësit ushtarak nënoficer, ushtar, ose i punonjësit civil ekuivalent me ta, sipas tabelës së organizimit dhe pajisjeve, bëhet nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.
3. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes lirohet nga detyra në rastet kur:
 - a) jep dorëheqjen.
 - b) mbush moshën për pension të plotë pleqërie.
 - c) bëhet i paafte përgjithmonë për kryerjen e detyrave, për shkak të kushteve shëndetësore.
 - ç) nuk mund të ushtrojë detyrën për një periudhë kohore më të gjatë se 6 muaj për pamundësi fizike dhe shëndetësore.
 - d) ka ristrukturim ose shkurtim funksioni organik.
 - dh) vlerësohet dy herë rresht “jo mjaftueshëm”.
 - e) nuk pranon të emërohet në një detyrë tjetër.
 - ë) përfundon kontratën e punës.
 - f) ka konflikt interesi me detyrën që kryen.
 - g) nuk pajiset ose i hiqet “certifikata e sigurisë”.
4. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes shkarkohet nga detyra në rastet kur:
 - a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë.
 - b) për shkelje të rënda disiplinore.
 - c) për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij dhe të institucionit.
5. Punonjësi ushtarak i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes nxirret në rezervë apo lirim nga shërbimi ushtarak, sipas legjislacionit në fuqi për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
6. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në momentin që lirohet ose shkarkohet nga detyra, dorëzon menjëherë detyrën.

Në këtë nen parashikohet që neni 34 dhe 40 i ligjit 65/2014, që kanë objekt të njëjtë, atë të emërimit, lirimit ose shkarkimit nga detyra të punonjësit ushtarak oficer ose të punonjësit civil ekuivalent me të, janë shkrirë në një, pasi janë përsëritje e njëri-tjetrit.

Në nenin 21 bëhet shfuqizimi i nenit 40 pasi është përfshirë në nenin 20.

Në nenin 22 parashikohet që neni 37, pika 3 të bëhen këto ndryshime:

- a) pika a, bëhet “jo më pak se 5 vjet në pozicion punonjës në funksion ekzekutues”.
- b) pika c, bëhet “jo më pak se 5 vjet në pozicion drejtues i nivelit të mesëm”.

Ndryshimet në kriteret kohore për përparimin në karrierë të punonjësit civil propozohen me qëllim jo vetëm dhënien e mundësive të tilla, por njëkohësisht krijimin e një numri punonjësish civilë me karrierë të konsoliduar.

Në nenin 23 parashikohet që titulli i nenit 48 ndryshon dhe bëhet “Kufizimi i lirisë së lëvizjes dhe për veprimtari të dyta”

Në nenin 48 shtohet pika 3, “Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes nuk mund të punësohet ose të kryejë veprimtari tjetër private pa marrë më parë miratimin me shkrim të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë”.

Për vetë specifikat e punës në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, nenit 48 i ligjit 65/2014 i shtohet edhe pjesa për kufizimin e kryerjes së veprimtarive të dyta nga punonjësit e agjencisë.

Në nenin 24 parashikohet që në nenin 49, shtohet pika 4, “Punonjësit civil të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në rastin e dërgimit me studime nga institucioni, trajtohet me pagë si punonjësit ushtarakë të kësaj agjencie”.

Duke qenë se punonjësit civil të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes gëzojnë statusin e ushtarakut, është propozuar të shtohet kjo pikë.

Në nenin 25 parashikohet që në nenin 51, pika 2, ndryshon dhe bëhet “Për nevoja të punës dhe interesa të shërbimit, orari dhe koha e punës mund të ndryshohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ose të eprorit të punonjësit. Në rast të kohëzgjatjes së kohës së punës, punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes kompensohet sipas legjislacionit në fuqi”.

Për vetë specifikën e punës së AISM, kërkohet që për sektorë të veçantë, orari i punës së personelit të jetë i ndryshëm nga ai i administratës publike dhe për këtë arsye është propozuar që në këtë nen të parashikohet jo vetëm kohëzgjatja por edhe ndryshimi i orarit të punës.

Në nenin 26 parashikohet që në nenin 54 pika 2, fjalët “në masën e gjysmës së pagës mujore” ndryshohen dhe bëhen “në masën e një pagë mujore”.

Bazuar në përvojat e trajtimit me veshmbathje të punonjësve të Shërbimit Informativ Shtetëror, Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Policisë Ushtarake, është propozuar që edhe punonjësit e agjencisë të trajtohen me veshmbathje në vlerë leku, një herë në vit, në masën e një page mujore të vendit të punës.

Në nenin 27 parashikohet që neni 59 ndryshon dhe bëhet

1. Për personelin ushtarak të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes zbatohet legjislacioni në fuqi për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2. Për personelin civil të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, ministri i Mbrojtjes, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, miraton rregulloren e disiplinës, kërkesat e së cilës janë të detyrueshme për zbatim.
3. Masat disiplinore për punonjës civil jepen kur veprimet dhe mosveprimet e tij nuk përbëjnë vepër penale.

Është propozuar të hiqet pika 2 e nenit 59 të ligjit 65/2014, sepse trajtohet në rregulloren e disiplinës, e cila miratohet me urdhër të ministrit të Mbrojtjes.

Në nenin 28 parashikohet që në nenin 61, pika 2, ndryshon dhe bëhet “Mënyra e raportimit të shkeljes disiplinore dhe procedurat për ngritjen dhe funksionimin e komisionit disiplinor përcaktohen në rregulloren e disiplinës. Pas propozimit të komisionit disiplinor, ministri i Mbrojtjes ose drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, vendos dhënien, mosdhënien ose ndryshimin e masës”.

Në nenin 61, tek pika 2 të shtohet

- a) “Masa disiplinore për shkronjën a dhe b të nenit 60, jepet nga drejtori i Përgjithshëm i AISM”.
- b) “Masat disiplinore për shkronjën c dhe ç të nenit 60 jepen nga autoriteti i cili ka emëruar personelin në detyrë”.

Neni 29 përcakton nxjerrjen e akteve nënligjore.

Neni 30 përcakton hyrjen në fuqi të ligjit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Me zbatimin e këtij projektligji do të ngarkohet Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Projektligji është dërguar për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Brendshme dhe Shërbimin Informativ të Shtetit.

Ministria e Drejtësisë pas bashkërendimit nëpërmjet shkresës nr.---, datë --.--.2022, ardhur nëpërmjet sistemit e-akte, është shprehur dakord me miratimin mbi projektligjin e propozuar.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë pas bashkërendimit nëpërmjet shkresës nr.---, datë --.--.2022, ardhur nëpërmjet sistemit e-akte, rishprehet parimisht dakord pas dakordësimeve të bëra mes strukturave tona edhe në rrugët elektronike zyrtare.

Ministria e Brendshme pas bashkërendimit me anë të shkresës nr.---, datë --.--.2022, ardhur nëpërmjet sistemit e-akte, është shprehur parimisht dakord me propozimin e projektligjit dhe relacionit shoqërues.

Shërbimi Informativ i Shtetit pas bashkërendimit nëpërmjet shkresës nr.---, datë --.--.2022, ka dërguar mendim mbi projektligjin e propozuar, ku është shprehur dakord me projektligjin e propozuar.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj ka efekte financiare shitesë për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes pasi është parashikuar që personeli i AISM të trajtohet me veshmbathje në vlerë leku, një herë në vit jo më “në masën e gjysmës së pagës mujore” por “në masën e një pagë mujore”.

Efektet financiare aktuale janë ---- lekë, nga ky ndryshim llogariten në vlerën ---- lekë në buxhetin vjetor të AISM dhe do të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, në fondet buxhetore të planifikuara në programin “Mbështetja e Luftimit”.

PROPOZUESI

MINISTRI I MBROJTJES

Niko Peleshi